



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/ 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 29.10.2020

Për: Operatorin Ekonomik “Univers Promotions” sh.p.k. NIPT K81324039M

Adresa: Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, Njësia Administrative Kashar, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr.23, datë 10.09.2020 me objekt: “**Blerje Uniforma**”, me fond limit **29.616.200** (njëzetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa T.V.SH., të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., me procedurë “E hapur”, me mjete elektronike e cila u zhvillua më datë 12.10.2020, ora 10:00. [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-71258-09-10-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Uniforma”,

Fondi Limit: **29.616.200** (njëzetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) Lekë pa t.v.sh.

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomike më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 12.10.2020, ora 10:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 14.09.2020* [70]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “**Malbertex**” sh.p.k., me NIPT K71821009N, me vlerë të ofertës ekonomike **28.549.500** (njëzetë e tetë milion e pesëqind e dyzetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH.;

2. Operatori Ekonomik “**Univers Promotions**” sh.p.k., me NIPT K81324039M me vlerë të ofertës ekonomike **28.550.500 (njëzetë e tetë milion, e pesëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH.;**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Malbertex” sh.p.k.,** NIPT K71821009N

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 1 të “**Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimit**”, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Ekstrakt nga QKB ku të vërtetohen se
 - a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
 - b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
 - d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- Nuk përmbush pikën **2.2.2 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për stafin e punonjësve si dhe listëpagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se **25(njëzetë e pesë)** punonjës për periudhën Janar 2020 –Korrik 2020, nga të cilët:
 - a) 3 (tre) punonjës të certifikuar për stampimin(kjo e vërtetuar me certifikatën/diplomën përkatëse nga kompani/insitucione të certifikuara)
 - b) 1 (një) punonjës të diplomuar për grafikë

- Nuk përmbush pikën **2.2.4 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik nuk ka vërtetuar se disponon faturë blerje apo dokument zhdoganimit si edhe inventarin e detajuar të dorezuar tek tatimet për pajisjet e mëposhtme:
 - 1 (nje) makineri stampimi
 - 1 (nje) makineri qendrisje
 - 1 (nje) furre per tharjen e stampimit
 - 1 (nje) prese pneumatike per ngjitjen e logos

- Nuk përmbush pikën **2.2.5 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur certifikata të lëshuara në emër të prodhuesit nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilët janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që vërtetojnë se mallrat

objekt prokurimi të mëposhtem janë në përputhje me standardet e mëposhtme:

- a) Kemishat – Sipas standartit **OEKO TEX 100** ose “ekuivalente”.
- b) Bluza me kopsa – Sipas standartit **OEKO TEX 100** ose “ekuivalente”.
- c) Xhup shiu – Sipas standarteve **SSH/ EN343:2003+A1:2007 klasi 3:1, SSH/ EN 20471:2013+A1:2016 klasi 3**.
- d) Bluza dimri me minge te gjata – Sipas standartit **OEKO TEX 100**. ose “ekuivalente”.
 - a. Pantallona shiu – Sipas standarteve **SSH/ EN343 rezistent ndaj ujit sipas Klasit A1, SSH/ EN 20471:2013+A1:2016 klasi 1**

- Nuk përmbush pikën **2.2.6 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur raporte testimi nga prodhuesi për artikujt e kërkuar ku të provohet dhe vërtetohet përputhshmëria me karakteristikat e kërkuara në specifikimet teknike, për artikujt: këmisha, bluza me kopsa, xhupa shiu, bluza dimri me minge të gjata dhe pantallona shiu.
- Nuk përmbush pikën **2.2.7 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi katalogu që Operatori Ekonomik ka paraqitur në sistem nuk përputhet me të gjithë artikujt e kërkuar në dokumentet e tenderit si dhe me specifikimet teknike të kërkuara.
- Nuk përmbush pikën **2.2.8 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në sistem deklaratën me shkrim ku i jep të drejtën “Autoritetit Kontraktor” të ndjekë dhe kontrollojë procesin e prodhimit për cilësinë e produkteve.
- Nuk përmbush pikën **2.2.9 (për kapacitetin teknik) “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**, pasi Operatori Ekonomik ofertues, nuk është paraqitur në datën **12.10.2020, ora 10.00** për të dorëzuar mostrat fizikë dhe të gjithë artikujt e kërkuar në dokumentet e tenderit (produkte të gatshme), sipas shtojces së specifikimeve teknike. Mosplotësimi i specifikimeve teknike për mostrat e paraqitura, sjell si pasojë skualifikimin e operatorit ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori Ekonomik **“Univers Promotions” sh.p.k.** me NIPT K81324039M me vlerë të ofertës ekonomike **28.550.500 (njëzetë e tetë milion, e pesëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind)** lekë pa T.V.SH. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor **“Posta Shqiptare” sh.a.**, Adresa: Rr, **“Reshit Çollaku”**, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.10.2020.

Ankesa: Nuk ka.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj

Konceptoi Sp. Prokurime: V. Kambellari

Pranoi Përgj.Prokurime: N.Lleshi

Miratoi Dr.Juridik: H.Biba

Konfirmoi Dr.Dep.Adm.Shoqërisë: A. Kaltanji